



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena/Prudato Received/Delivery	27 - 07 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	4371/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.524/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.524/2022 të datës 13.06.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.524/2022 e datës 13.06.2022 e parashtruar nga ankuesi dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- II. **Obligohet** Komisioni për Rrotacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj kërkesën e ankuesit për shprehje të interesit të datës 09.02.2022 sipas Shpalljes së Shprehjes së Interesit nr. ref.08/2022 të datës 08.02.2022 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- III. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për zbatimin e vendimit siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 13.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3401/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me mos dërgim në mision diplomatik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 16.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit më datë 17.06.2022 ka përcjell në Këshill provat lidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3401/2022 të datës 13.06.2022, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për shprehje të interesit për dërgim në mision diplomatik/konsullor të datës 09.02.2022; CV-në e ankuesit; e-mailin e datës 14.02.2022 nga ankuesi; Kërkesën për qasje në dokumente publike të datës 18.03.2022 nga ana e ankuesit; Vendimin me numër protokollit 1787 të datës 24.05.2022; Listën e kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën Konsull i Përgjithshëm sipas thirrjes për shprehje të interesit të datës 08.02.2022; e-mailin e datës 13.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.06.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 17.06.2022; Akt-in e Emërimit me numër protokollit 2049 të datës 13.06.2022; Raportin e Komisionit të Rotacionit të datës 25.02.2022; Shpalljen e shprehjes së interesit të datës 08.02.2022; e-mailin e datës 06.07.2022 dhe 13.07.2022 nga _____ për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku ka konstatuar së ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020, gjegjësisht neni 4 paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar se: *1.Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, 2.Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, ndërlidhur me këtë, e në mungesë të rregullave të veçanta lidhur me procedurën e rotacionit të stafit në misione diplomatike dhe konsullore, trajtimi i kësaj çështje juridike-administrative bazohet në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesi sipas Akt-it të Emërimit me numër protokollit 2049 të datës 13.06.2022 është emëruar në pozitën *Zyrtar i Lartë për Emergjenca* në Qendrën për Menaxhimin e Krizave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Me tej nga shkresa e lëndës rrjedhë së Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 08.02.2022 ka bërë Shpalljen e shprehjes së interesit për pozitën e liria për misione diplomatike dhe konsullore. Ankuesi më datë 09.02.2022 ka aplikuar për pozitën në mision diplomatik dhe konsullor në Vjenë-Sekretar i tretë deri Sekretar i parë, Këshilltar deri ministër këshilltar, _____ deri Sekretar i Parë dhe Cyrih-Atashe deri Sekretar i Parë, ndërsa më datë 14.02.2022 i njëjti është tërhequr nga

opsioni në Cyrih. Komisioni i Rotacionit sipas Raportit të datës 25.02.2022 nuk ka rekomanduar ankuesin për asnjërin nga vendet që ka aplikuar.

Ankuesi me datë 18.03.2022 parashtron kërkesë për qasje në dokumente zyrtare-procesverbalin e Komisionit të themeluar për shprehje të interesit e shpallur me datë 08.02.2022, e cila kërkesë është aprovuar me Vendimin Nr.164/2022 të datës 24.05.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar Shpalljen e shprehjes së interesit të datës 08.02.2022 për pozitat e lira për misione diplomatike dhe konsullore sipas të cilës si kriteret specifike janë evidentuar: *a. Grada diplomatike/konsullore sipas kërkesës së paraqitur për pozitën përkatëse; b. vlerësimet pozitive vjetore të rezultateve të punës; c. Të kenë përgatitjen e duhur profesionale; d. Të kenë reputacion të lartë; e. Trajnime profesionale (Akademia Diplomatike e MPJD-së dhe institucione të tjera)*". Kandidati preferohet t'i plotësoj edhe këto kriteret: *"a. njohuri të një gjuhe të shtetit pranues; b. Njohur për shtetin pranues ose rajonin ku ndodhet shteti pranues e sidomos për historinë, ekonominë dhe kulturën e vendit; c. Aftësi integruese ose tolerancë e lartë ndaj kulturës, ose realitetit socio-kulturor të shtetit pranues; d. Të kenë shërbyes së paku një vit (1) efektiv në ministri pas kthimit nga misioni"*, ndërsa Komisioni i Rotacionit i themeluar sipas Vendimit nr.71/2022 të datës 16.02.2022 të Ministres së MPJD-së, me Raportin e datës 25.02.2022 nuk ka përfshirë ankuesin në asnjërin nga pozitat e aplikimit rrjedhimisht Kolegji nga shqyrtimi i listave të vlerësimit ka gjetur se ankuesi është vlerësuar se ka përmbushur kriteret e përcaktuar sipas Shpalljes se datës 08.02.2022 përkatësisht ankuesi ka plotësuar kushtin e gradës, gjuhës, përvojës, mirëpo Komisioni ka konstatuar se ankuesi plotëson pjesërisht kriteret specifike duke mos saktësuar së cilat nga kriteret specifike ankuesi nuk i ka plotësuar dhe në këtë mënyrë nuk e ka përfshirë të njëjtin në rekomandimet për përzgjedhje dhe emërim nga ministrja e MPJD-së.

Po ashtu, Kolegji me asnjë provë nuk ka arrit të konstatoj së Komisioni për Rotacion ka njoftuar kandidatet lidhur me ecurinë e procedurës sipas Shpalljes për shprehje të interesit të datës 08.02.2022, duke përfshirë njoftimin lidhur me apo mos plotësimin e kriterëve të përcaktuara për këto pozita, informimin e aplikantëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre në procedurën administrative si dhe udhëzimin lidhur me të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike, veprim ky që sipas Kolegjit të Këshillit është në kundërshtim më parimet bazë të procedurës së përgjithshme administrative të përcaktuara me nenin 9, nenin 11 dhe nenin 13 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht me parimin për administratë të hapur, parimin e informimit si dhe parimin e të drejtës në mjete juridike.

Nisur nga rrethana dhe mbështetur në konstatimet si me lartë Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Rotacion i themeluar sipas Vendimit nr.71/2022 të datës 16.02.2022 të Ministres së MPJD-së është i obliguar që të rishqyrtoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë kërkesa e ankuesit për shprehje të interesit të datë 09.02.2022, të eliminoj shkeljet e konstatuar sipas këtij vendimi, dhe të veproj në pajtim me dispozita ligjore përkatëse.

Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.524/2022

Avdyll BEKTESHI

Bektashi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Komisionit të Rotacionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së

